



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

WORLD UNIVERSITY SERVICE (WUS) OFRON TRAJNIME ME BURSË PËR STUDENTËT NË SHQIPËRI

Në kuadër të programit “World University Service” Zyra Qendrore Ndërkombëtare WUS në Gjermani po zbaton projektin ndërkombëtar “Bursa për Shqipërinë”. University World Service (WUS) është një organizatë ndërkombëtare, e cila operon si një komunitet për studentë, mësues dhe punonjës të sektorit të arsimit në 50 vende të botës përmes komiteteve kombëtare. Zbatimi i tij synon të lehtësojë elitën e arsimuar shqiptare dhe të punësuarit e rinj të kualifikuar në Shqipëri dhe të mundësojë zhvillimin e perspektivës profesionale në të ardhmen. Në kuadër të këtij projekti studentët shqiptarë do të kenë mundësinë që të marrin pjesë në trajnime pranë universiteteve publike shqiptare për vitin akademik 2018-2019. Projekti financohet nga Ministria e Ekonomisë, Energjisë, Transportit dhe Zhvillimit Rajonal “Hessian” në Gjermani. Kurset e trajnimit iu adresohen studentëve të universiteteve publike shqiptare, të cilët:

- Janë në përfundim të studimeve të tyre (Master) dhe/ose që pritet të diplomohen përgjatë vitit akademik 2018-2019,
- Kanë përfunduar studimet në një afat kohor prej jo më shumë se 6 muaj,
- Kanë një ide biznesi (*start-up*) ose dëshirojnë të kryejnë një praktikë.

Studentët ose punonjësit që janë në fillimet e karrierës së tyre do të përfitojnë këshillime dhe trajnime për teknikat e aplikimit, sipërmarrjen, karrierën dhe për ofertat e praktikave të punës. Gjatë trajnimeve individuale dhe në grupe, të cilat parashikohen të zgjasin për një periudhë 3-6-muaj, në varësi të llojit të bursës që arrin në shumën prej 250,00 € në muaj, studentët do të marrin njohuri edhe për çështje të tilla se si mund të aplikojnë për punë dhe të fillojnë një biznes të ri. Për kandidatët me të ardhura të pakta familjare do të aplikohen kriteret preferencialë.

Trajnimet parashikohen të zhvillohen gjatë periudhës Gusht 2018 - Shkurt 2019 dhe do të mbahen në ambiente të caktuara në rrethet përkatëse sipas listës në vijim:

1. **Gjirokastrë**, 13 Maj 2018, Hotel “Çajupi”;
2. **Vlorë**, 20 Maj 2018, Hotel “Pavarësia”;
3. **Korçë**, 3 Qershor 2018, Hotel “Konti”;
4. **Shkodër**, 10 Qershor 2017, Universiteti i Shkodrës;
5. **Elbasan**, 1 Korrik 2018, Hotel “Imperial”;
6. **Tiranë dhe Durrës**, 8 Korrik 2018, Tirana Business Park.

Afati i fundit i aplikimit për studentët e Universitetit të **Vlorës, Korçës, Shkodër, Elbasan, Tiranë, Durrës** është **1 javë** para fillimit të trajnimit, ndërsa për studentët e Universitetit të **Gjirokastrës** ky afat përfundon **2 ditë** përpara fillimit të trajnimit. Numri i studentëve të pranuar për të marrë pjesë në kurset e trajnimit është i kufizuar dhe parashikohet të jetë deri në 30 studentë. Gjithashtu kandidatët duhet të kenë njohuri shume të mira të gjuhës angleze.

Studentët që nuk marrin pjesë në trajnim nuk kanë të drejtë të aplikojnë për bursë. Afati i fundit për aplikimin për bursë është data 15 Gusht 2018.

Informacione të mëtejshme si dhe formularët e aplikimit, i gjeni bashkëlidhur këtij njoftimi ose në adresat: www.surplace-albania.de, albania@wusgermany.de, www.wusgermany.de <http://www.wusgermany.de/en/international-projects/scholarship-albania/internship-grant-2018>; ose mund të komunikoni direkt nëpërmjet Znj. Eda Terezi, Koordinatore e Projektit për Shqipërinë: e-mail: Terezi@wusgermany.de -

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS